

UDHËZIM
Nr. 19, datë 11.8.2016

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2016, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, 27 dhe 50, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon

- | | |
|------------------|---------------|
| a) Gjuhë e huaj: | 25 gusht 2016 |
| b) Gjuhë shqipe: | 27 gusht 2016 |
| b) Matematikë: | 29 gusht 2016 |

2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) të zhvillojnë provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, në datën 22 gusht 2016.

3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 119, datë 20.3.2016, për miratimin e rregullore “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016”

4. Provimet kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, përcaktuar në pikën 1 dhe 2 këtij udhëzimi, të fillojnë në orën 10:00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Hartimi i testeve kryhet sipas rregullore për procesin e organizimit dhe të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016.

6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Gjirokastër. Zyra arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastër tezën, ditën e provimit.

7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.

8. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve qendra.

9. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla